


PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Itali / Sqarim për afatin e qëndrimit të shtetasve të huaj



Shtetasve të huaj në territorin italian nuk do u jepet masa e përjashtimit nga Italia pas situatës së krijuar për shkak të COVID-19. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka bërë një sqarim për të gjithë shtetasit shqiptarë që ndodhen në Itali për sa u përket afatit të qëndrimit. Sipas njoftimit, që nga data 2 mars 2020 është vendosur një pezullim 30 ditor i afateve për procedimet administrative lidhur me qëndrimin e të huajve në territorin italian. Më tej, bëhet e ditur se pezullimi në kuadër të kësaj situatë vlen si për procedurat e lidhura me lejet e qëndrimit (aplikim i parë ose rinovim), ashtu edhe për vizat.

Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Gjermani / Nisma e mjekëve të diasporës për ndihmë komunitetit shqiptar

Shoqata e mjekëve shqiptarë në Gjermani - Grupet e punës

Te themeluar 11/16	Te konfirmuar 3/16
<ul style="list-style-type: none"> 1. Saarland • Florenc Buxha 2. Niedersachsen • Aide Pashi 3. Hamburg & Bremen • Enkelejdja Ibro 4. Thüringen • Ali Hajdari 5. Nordrhein-Westfalen • Besmir Elmazi • Ermal Xhaho 6. Rheinland-Pfalz • Krisid Boshku 7. Baden Württemberg • Kristela Mico • Genc Kelimendi 8. Hessen • Gani Oruçaj • Erion Shishmani 	<ul style="list-style-type: none"> 10. Sachsen • Besa Zylbeari • Rezart Qorri (Stomatolog) 11. Sachsen-Anhalt • Shkelqim Reçi 12. Berlin • Andi Rroku 13. Brandenburg • Edon Kabashi 14. Bayern • Kristi Xhunga 15. Mecklenburg-Vorpommern 16. Schleswig-Holstein

Në themelimin e siper

Mjekët e Diasporës shqiptare janë angazhuar në ofrimin e kujdesit shëndetësor për qytetarët nisur nga situata e krijuar nga koronavirusi. Anëtarët e Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Gjermani, disa nga të cilët ishin pjesëmarrës në Takimi e Mjekësisë në Diasporë në 20 shkurt, kanë marrë një nismë të veçantë në ndihmë të komunitetit shqiptar. Nisur nga situata e krijuar nga koronavirusi, ata janë angazhuar për t’u ofruar ndihmë shëndetësore të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Gjermani. “Mjekët do tu vijnë në ndihmë të gjithë shqiptarëve që ndodhen në Gjermani, pushuesve, punëtorëve që shfrytëzojnë periudhën e 90 ditëve të qëndrimit, të gjithë atyre që janë me apo pa vizë (leje qëndrimi), pa mjek familje, pa sigurimin e duhur shëndetësor dhe që nuk dinë mirë gjuhën gjermane”, thuhet në njoftim. Kjo shoqatë ka anëtarë në 11 lande nga 16 që janë gjithsej në Gjermani.

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Autorët e javës nga Takimi i Shkrimtarëve të Diasporës

TAKIMI I SHKRIMTARËVE TË DIASPORËS
Letra nga Diaspora
22 SHKURT 2020

Alau Nisaj
Itali

Ndue Ukaj lindi në Stubëll të Epërme të Kosovës dhe është shkrimtar, kritik i letërsisë e publicist. Ka publikuar një sërë veprash poetike, ese e studime, është përfshirë në antologji poetike e revista prestigjioze, brenda e jashtë vendit. Poezitë dhe tekstet e tij janë përkthyer në anglisht, spanjisht, italisht, rumanisht, finlandisht, kinezisht, suedisht, turqisht dhe vlerësuar me shumë çmime letrare. E ndan jetën mes Kosovës e Suedisë.

TAKIMI I SHKRIMTARËVE TË DIASPORËS
Letra nga Diaspora
22 SHKURT 2020

Besa Myftiu


Besa Myftiu lindi në Tiranë dhe është vajza e shkrimtarit disident Mehmet Myftiu. Ka punuar si gazetare dhe ka shkruar skenarin e filmit televiziv “Unë e dua Erën” (1991). Është pedagoge në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Lozanë të Zvicrës. Është autore e vëllimit poetik në dy gjuhë “Miq të humbur /Des amis perdus”, e disa romaneve në gjuhën frënge dhe e një përmbledhjeje me tregime, të cilat janë botuar edhe në gjuhën shqipe.

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti

e-albania.al/dhuro
e-albania.al/donate

Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin “e-Albania”.

QBD ofron falas përdorimin e platformës “Schoolme”



Nisur nga situata e krijuar, Qendra e Botimeve për Diasporën ju rikujton të gjithë mësuesve të Shkollave të Gjuhës Shqipe në Diasporë përdorimin falas të platformës digjitale “Schoolme” që mundëson shërbimin e mësimdhënies në distancë. Platforma mundëson shpjegimin e lëndëve të ndryshme në gjuhën shqipe nga mësues të kualifikuar, duke pasur në dispozicion video shkencore, filma, imazhe, dokumente, harta specifike, për një shtjellim më të thelluar dhe më të përditësuar të të gjitha temave mësimore të renditura sipas programit shkollor të miratuar nga institucionet arsimore përgjegjëse të Shqipërisë dhe Kosovës.

Dëgjo pa limit



“Unë rri në shtëpi dhe dëgjoj audiobooks” është platforma e librave me zë nga shoqëria e sigurimeve “Sigal”, bashkëpunëto e Qendrës së Botimeve për Diasporën. Këtë platformë mund ta shfletoni [këtu](#).

KKD/ Ardian Lekaj: Coronavirusi infektion sistemin ekonomik!



Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare përmes një artikulli ka shprehur opinionin e tij, për ndikimin që do të ketë situata e krijuar për shkak të virusit Covid-19 në sistemin ekonomik global. “Mendoj se sot jemi në një luftë ekonomike. Kjo situatë ishte e pashmangshme për ekonominë botërore. Diçka e këtij apo atij lloji do të ndodhte, pasi ekonomia nuk mund të vazhonte në të njëjtën mënyrë. Paraja sot nuk ka asnjë vlerë, bile dhe interesi i bankar në Europë është negativ”, shprehet Lekaj.

COVID-19 RREGULLAT E REJA

- Ndalohen aktivitetet sportive, kulturore, konferenca, koncerte, tubime dhe dëgjesa publike deri më datë 3 Prill
- Mbyllen diskot, lokale nate, ambiente për argëtim, si qendra sociale, palestra, pishina deri më 3 Prill
- Restorantet, baret të ofrojnë shërbime për qytetarët duke respektuar distancën prej së paku 2 m nga tavolinat dhe së paku 1 metër qytetarët nga njëri tjetri.
- Pezullohen të gjithë procedurat për konkurset për procedurat për punësim
- Mbyllen çerdhet dhe institucionet arsimore deri më 23 Mars
- Ndalohet lëvizja e udhëtarëve me mjetet e transportit publik qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas për periudhën deri më 3 prill 2020
- Ndalohen lëvizjet e udhëtarëve me mjetet e transportit ajror dhe detar drejt Italisë.

Për të parandaluar përhapjen e koronavirusit në vend: KORONAVIRUS

- Pezullohen fluturimet dhe udhëtimet në rrugë detare me verilin e Italisë, me të gjithë zonat e kuqe të izoluar plotësisht deri më datë 3 Prill.
- Mbyllen institucionet arsimore për një periudhë 2 javore.
- Ndalohen grumbullimet masive, aktivitetet sportive, kulturore, konferenca, dëgjesa publike deri më datë 3 Prill.
- Vetë-karantinim i detyruar për personat që vijnë nga zonat me shpërthime komunitare, zonat e kuqe, i cili do të monitorohet me rigorozitet nga strukturat shëndetësore. Ky vendim është i shoqëruar edhe me masa administrative për këdo e thyen këtë rregull.